

**FATMIRA MUSAJ**

**BALLAFAQIMI SHQIPTARO-GREK PËR KISHËN  
ORTODOKSE AUTOQEFALE SHQIPTARE  
(1925-1928)**

Konsolidimi i mëtejshëm i shtetit shqiptar dhe i pavarësisë së tij në vitet e Republikës, lidhej edhe me zgjidhjen e çështjes së komuniteteve fetare, thelbi i së cilës qëndronte në pavarësimin e tyre nga selitë që ndodheshin jashtë vendit, me organizimin dhe vendosjen e marrëdhënieve me shtetin në përputhje me reformat politike, administrative dhe juridike të ndërmarra në këtë periudhë. Hapi i parë në këtë drejtim u hodh me Shpalljen e Pavarësisë kombëtare në vitin 1912 dhe u çua më tej në vitet 1920-1924. Rifitimi i pavarësisë dhe lëvizja për demokratizimin e institucioneve shtetërore dhe jetës së vendit, nxitën klerin drejtues të komuniteteve bektashi,<sup>1</sup> ortodoks<sup>2</sup> e mysliman<sup>3</sup> të organizonin kongreset e tyre, ku vendosën për t'u shkëputur nga qendrat jashtë vendit dhe riorganizimin institucional mbi baza kombëtare. Në këtë përpjekje ata kërkuan edhe ndihmën e institucioneve shtetërore.

Arritjet e këtyre viteve në çështjen fetare, A. Zogu i shfrytëzoi për të hedhur hapa të mëtejshëm për zgjidhjen përfundimtare të pavarësimin dhe reformimit të tyre. Këtë proces ai nuk e ndau nga përpjekjet për modernizimin, centralizimin e laicizimin e shtetit. Parimet e kësaj politike u sanksionuan në Kushtetutën e Republikës, ku theksohej se: "Republika e Shqipërisë s'ka fe zyrtare".<sup>4</sup> Konfirmimi i laicizimit si tipar i shtetit modern, për Shqipërinë kishte rëndësi të veçantë, sepse në kushtet e ekzistencës së besimeve të ndryshme, ai e bënte shtetin një institucion të përbashkët për të gjithë shtetasit pavarësisht përkatësisë fetare, i mbante fetë larg reformave shtetërore dhe pengonte depërtimin e

<sup>1</sup> Fatmira Musaj, "Institucionalizimi i Tarikatit Bektashian në Shqipëri në vitet 1920-1939", në *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*. Prishtinë: 1995, f. 225.

<sup>2</sup> Visarion Xhuvani, *Kujtim veprë dhe intrigë*, Tiranë: Shtypshkronja Tirana, 1926, f. 7-8.

<sup>3</sup> Gazmend Shpuza, "Kongresi mysliman shqiptar 1923", në revistën *Kultura Popullore*, nr. 1-2, Tiranë: 1997, f.189.

<sup>4</sup> *Statuti i Republikës Shqiptare*, 1925, Shtypshkronja Nikaj, f. 4.

influcencës së huaj, në punët e brendshme të tij. Parimet e politikës fetare të shtetit në përgjithësi, nuk u kundërshtuan nga kleri drejtues i komuniteteve fetare dhe veçanërisht nga ai mysliman, ndonëse ato ishin në kundërshtim me frymën tradicionale të tij.<sup>5</sup> Pas shkëputjes zyrtarisht nga Kalifati në vitin 1924, kleri mysliman iu kushtua reformimit në aspektin fetar, kulturor e institucional, duke i qëndruar larg politikës. Meqenëse ishte komuniteti fetar më i madh në Shqipëri, që shkonte deri në 71% të popullsisë,<sup>6</sup> qëndrimi i tij, i krijoi mundësi A. Zogut dhe qeverisë, për të drejtuar vëmendjen në pavarësimin e Kishës Ortodokse Shqiptare (KOSH) dhe në rregullimin e marrëdhënieve me kishën katolike e lidhjen e konkordatit me Vatikanin.

### **Përpyjekje për pavarësimin e KOSH**

KOSH dhe Këshilla e Lartë, pas afro tre viteve të kongresit të Beratit, nuk kishin arritur të zbatonin vendimet e tij për organizimin e institucioneve të saj kombëtare dhe shkëputjen *de jure* nga Patrikana e Stambollit. Ato u penguan nga qëndrimi dhe veprimi i klerikëve të lartë brenda kishës, të cilët për interesat personale dhe të influencuar nga kisha greke e Patrikana, bllokuan funksionimin e Këshillit të Lartë për dorëzimin e mitropolitëve shqiptarë për dioqezën e Durrësit e të Gjirokastrës të cilët do të formonin sinodin kishtar, thirrjen e Kongresit që do të miratonte statutin përfundimtar të kishës.<sup>7</sup>

Kundër pavarësisë së KOSH ishte shteti dhe kisha greke. Qysh në krye të herës, ata nuk e pranuan një fakt të tillë dhe protestuan deri në Lidhjen e Kombeve duke e paraqitur shpalljen si një puç.<sup>8</sup> Ata synonin që KOSH të mos ishte në të njëjtin status me kishën greke, por të ishte nën varësinë e saj. Grekët vunë në lëvizje Patrikanën për të penguar autoqefalinë e KOSH. Kështu Patrikana, në prill 1923, në bisedimet me komisionin prej 7 anëtarësh të KOSH që u zhvillua në Konstandinopojë, i

<sup>5</sup> Aleksanër Popoviç, *Islamizmi Ballkanik*, Tiranë: Dituria, 2006, f. 34.

<sup>6</sup> Roberto Morozzo della Rocca, *Kombësija dhe feja në Shqipëri (1920-1944)*, Tiranë: Elena Gjika, 1994, f.4.

<sup>7</sup> V. Xhuvani, *Kujtim veprë ...*, f.12-17.

<sup>8</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-V-230, Apostolos A. Glavinas, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë*, përkthyer nga Q. Kambo, Botim i dytë, Selanik: 1989, f. 46.

njohu Kishës Ortodokse Shqiptare vetëm vetadministrimin në kuadrin e kishës krahinore, gjë që u kundërshtua nga komisioni.<sup>9</sup>

Shteti grek edhe në vitet e Republikës Shqiptare, i vazhdoi përpjekjet për të patur protektoratin mbi KOSH dhe shkollat greke në Epirin e Veriut, si dy mjete të fuqishme të politikës së tij helenizuese, për shkombëtarizimin e ortodoksëve shqiptarë në këtë rajon.<sup>10</sup> Për realizimin e kësaj politike Greqia, veç influencës brenda kishës, synoi të gjente mbështetje edhe në qarqet politike të shtetit shqiptar. Në këtë kuadër, ajo shfrytëzoi përgatitjet e A. Zogut, për t'u rikthyer në pushtet. Në këmbim të ndihmës që do t'u ofronte mbështetësve të tij të arratisur në Greqi, u kërkoi që pas marrjes së pushtetit, të mos përziheshin në çështjet e kishës ortodokse, në funksionimin e lirë të shkollave greke në Epirin e Veriut dhe mësimin e gjuhës greke në shkollat shqiptare në se kjo kërkohet nga komunitetet vendore etj.<sup>11</sup> Mihal Kaso (ish deputet në Asamblenë Kushtetuese), në fund të gushtit 1924 i paraqiti A. Zogut në Beograd kërkesat e qeverisë greke.<sup>12</sup> Ky i fundit, i pranoi ato dhe i vlerësoi si të ekuilibruara dhe të arsyeshme.<sup>13</sup> Ashtu si me Beogradin edhe me Athinën, premtimet e A. Zogut nuk kishin fuqi legale detyruese, por vetëm morale, pasi ai ishte në pozitën e një emigranti politik.

Pas rikthimit të A. Zogut në pushtet, qeveria greke, me anë të ministrit të saj në Durrës Panurias, i kërkoi atij të mbante premtimet që kishte bërë. Nga ana e saj Athina premtonte se do të pranonte studentë shqiptarë për t'u arsimuar në Greqi, të fuste mësimin e gjuhës shqipe si gjuhë të dytë, në shkollat e Korfuzit që frekuentoheshin nga shqiptarë etj.<sup>14</sup> Pas gatishmërisë së Zogut për të pranuar dëshirat e qeverisë greke,

<sup>9</sup> *Po aty* f.47.

<sup>10</sup> Fatmira Rama, "Sinodi i Parë shqiptar dhe Kongresi i dytë Panortodoks i KOASH", në *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 19 shtator 1992, f.62.

<sup>11</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές Σχέσεις*, επιμέλεια: Βασίλειος Κόντης, Έγγραφα από το Ιστορικό Αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, Τόμος III, 1922-1929, Αθήνα: Εστιας, 2004 (*Helenizimi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet greko-shqiptare*, nën kujdesin e Vasil Kondisit, Dokumente nga Arkivi Historik i Ministrisë së Jashtme, Vëllimi III, 1922-1929, Athinë: Estia, 2004), dok. Nr. 47, Telegram i ambasadorit grek Camadhos në Beograd për MPJ Athinë, Beograd, 3 shtator 1924.

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> *Po aty*.

<sup>14</sup> *Po aty*, dok. nr. 63, Telegram i Panurias, për ministrinë e Punëve të Jashtme në Athinë, Durrës, 3 shkurt 1925.

Panurias i kërkoi të shprehej konkretisht për premtimet e dhëna. A. Zogu theksoi se në një kohë të mëvonshme do të diskutonte me të, për veprimet që duhej të ndërmerreshin për çështjen kishtare, ndërkohë do të pezullonte emërimin e prefektit të Korçës, pasi dëshironte t'i jepte atij udhëzime të qarta për këtë çështje. Njëkohësisht ai pranoi të thërriste në Tiranë mitropolitin e Korçës, Jerotheon për të bërë marrëveshje parapërgatitore.<sup>15</sup> Sipas Panurias, rregullimin e çështjes kishtare A. Zogu e shihte edhe në aspektin e interesave të tij politike. Ai e konsideronte KOSH si një instrument të Fan S.Nolit dhe do të bënte përpjekje për ta shfuqizuar atë me çdo kusht.<sup>16</sup> Vonesën në mbajtjen e premtimeve A. Zogu e justifikoi me angazhimin e tij për stabilizimin e jetës politike në vend, ngritjen e institucioneve shtetërore dhe zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për shtetin si dhe me faktin se Asambleja Kushtetuese ende nuk kishte përcaktuar të drejtat dhe kompetencat e tij si president i Republikës.<sup>17</sup> Të njëjtat premtime A. Zogu i bëri Panuriasit edhe në takimet e 13 shkurtit dhe të 6 marsit. Ai u zotua, se çështjen e kishës ashtu si dhe probleme të tjera, do t'i zgjidhte me mjete paqësore e në përputhje me ligjet e shtetit dhe do t'i përmbushte sapo të përfundonte Asambleja.<sup>18</sup> Gjithashtu Zogu premtoi se do të lejonte çeljen e shkollës hieratike në Gjirokastrë, dhe se kishte për qëllim që elementi i krishterë të mbetej krejtësisht i kënaqur dhe në pozita më të mira se myslimanët. Madje, shkoi edhe më tej duke deklaruar se dëshironte të lidhej më ngushtë me Greqinë, pasi synonte të çlirohej nga serbët dhe se ndaj Italisë kishte një qëndrim armiqësor.<sup>19</sup>

Politikën e shtyrjes së bisedimeve, pa hedhur anjë hap konkret në realizimin e premtimeve, A. Zogu e ndoqi edhe për disa muaj. Atij nuk i interesonte të ashpërsonte marrëdhëniet me fqinjin jugor, në një kohë kur po shkëputej nga Jugosllavia dhe kishte filluar bisedimet me Italinë për nënshkrimin e një sërë marrëveshjesh ekonomike të cilat do të pasoheshin me ato politike. Ky qëndrim i kujdesshëm lidhej me gjendjen e pastabilizuar si të pushtetit dhe të stabilizimit të jetës politike në vend. Në të vërtetë, Zogu nuk kishte ndërmend të respektonte premtimet për të

<sup>15</sup> *Po aty.*

<sup>16</sup> *Po aty.*

<sup>17</sup> *Po aty.*

<sup>18</sup> *Po aty*, dok. nr. 64, Telegram i Panurias për MPJ në Athinë, Durrës, 13 shkurt 1925; *po aty*, dok. nr. 66, Telegram i Panurias për MPJ, Athinë, Durrës, 6 mars 1925.

<sup>19</sup> *Po aty*, dok. nr. 64, Telegram i Panurias për MPJ Athinë, Durrës, 13 shkurt 1925.

mos u përzierë në çështjen kishtare. Autoqefalinë e kishës ai e konsideronte si një faktor të rëndësishëm për konsolidimin e pavarësisë së vendit, dhe për largimin e influencës së kishës dhe qeverisë greke nga komuniteti ortodoks shqiptar dhe nga trevat e pretenduara prej saj. Të dhënat dokumentare dëshmojnë se çështja e kishës dhe e pavarësisë së saj, do të mbetej një nga prioritetet e politikës qeverisëse në periudhën e Republikës. Kjo u vu re në pritjen që Zogu u bëri në fillim të marsit 1925, mitropolitit të Korçës Jerotheut dhe atij të Beratit Kristofor (Kissi), me rastin e zgjedhjes President i Republikës. Ai vlerësoi rolin dhe rëndësinë që kishte kisha për shtetin shqiptar dhe i ftoi ata, që bashkërisht, të përpiqeshin për lartësimin e saj dhe, veçanërisht, për përmirësimin e jetës së vëllezërve ortodoksë.<sup>20</sup> Ndërsa grekët shpresonin që takimi me Jerotheun të shoqërohej me marrëveshje konkrete për çështjen e kishës, Zogu e përcolli atë duke i dhënë vetëm dekretin për çeljen e dy shkollave fetare në Korçë dhe në Gjirokastrë që do të shërbenin për përgatitjen e klerikëve shqiptarë. Mungesa e tyre ishte përdorur nga kisha greke për të ruajtur monopolin e klerikëve të lartë në KOSH. Përgatitja e klerikëve shqiptarë do të pastronte kishën në mënyrë graduale nga klerikët e huaj.<sup>21</sup>

Për qeverinë shqiptare, ishin të rëndësishme, si çështja e kishës ashtu edhe ajo e pronave shtetërore në Sarandë. Grekët kishin pretendimet e tyre për legalizimin e këtyre pronave të marra me qira në interes të shtetasve grekë, për çeljen e shkollave greke dhe përdorimin e gjuhës greke në kishat ortodokse të këtij rrethi. Ngritja e komisionit qeveritar për vlerësimin e qirave të pronave të shtetit që nga viti 1918 dhe mbledhja e tyre, rriti tensionin në qarqet greke. Këtë veprim nënkonsulli grek i Sarandës e konsideroi "... si një plan të qeverisë shqiptare për çrrënjosjen e të krishterëve të këtushëm".<sup>22</sup> Jo vetëm kaq, por këtë situatë ai e shihte edhe si një zhgënjim në pritmërinë e zbatimit të premtimeve të bëra nga ana e qeveritarëve shqiptarë. "A. Zogu,- theksonte ai,- premtoi barazi ligjore për të gjithë qytetarët, sjellje të mirë karshi të krishterëve dhe plot fjalë të bukura, por të krishterët e këtushëm nuk patën rast t'i shohin të

<sup>20</sup> "Çështje të kishës autoqefale të Shqipërisë", *Gazeta e Korçës*, nr. 170, 10 mars 1925, f.1.

<sup>21</sup> *Dielli*, nr 2868(411), 28 maj 1925, f.1.

<sup>22</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου ...*, dok. nr. 71, Telegram i nënkonsullit grek Argjiropulos në Sarandë për Ministrinë së Jashtme, Sarandë, 9 maj 1925.

përmbushura këto premtime ....<sup>23</sup> Premtojnë me tepri por, kur shfaqet çasti për t'i mbajtur ato, dalin shumë pengesa, sot zgjedhjet, nesër kjo apo ajo. Del pyetja: nëse ne mbështetëm A. Zogun për të dëbuar Nolin, sa e përmirësoi gjendjen tonë ky kontribut? Në mos e përkeqësoi, kjo situatë nuk mund të quhet përmirësim”<sup>24</sup> Zhgënjimi i palës greke për të gjetur te Zogu mbështje për politikën e saj në Shqipëri, shtoi druajtjen në diplomacinë e vendit fqinj se nuk do të ishte e largët koha kur pala shqiptare do të zgjohej e të mbronte edhe minoritetin çam çka, sipas tyre, do të anulonte të gjithë punën e këmbimit të kësaj popullsie, të bërë deri në këtë kohë sipas Traktatit të Lozanës.<sup>25</sup>

Ndërsa te pala greke nisën të zbeheshin shpresat për një mbështetje të politikës së tyre në Shqipëri nga A. Zogu. Te ky i fundit dhe qeveria, ishte krijuar bindja se pa siguruar një kishë e arsim kombëtar, duke përfshirë edhe minoritetet në respektim të plotë të konventës së minoriteteve të Lidhjes së Kombeve (1921), nuk mund të konsolidohej shteti dhe pavarësia e tij. Të qartë për vështirësitë që kishte hasur elementi kombëtar brenda dhe jashtë kishës për realizimin e vendimeve të kongresit të Beratit (1922), A. Zogu dhe qeveria mbështetën politikisht procesin, duke u bërë pjesë e tij. Një nga drejtimet kryesore ishte krijimi i Sinodit i cili, sipas vendimeve të Kongresit, kishte për detyrë organizimin e brendshëm institucional të kishës kombëtare dhe finalizimin e pavarësimit të saj nga Patrikana.

Në vitin 1922, Këshilli i Naltë i kishës, emëroi në krye të mitropolive të Korçës dhe të Beratit, përkatësisht peshkop Jerotheon nga Çarshova e Përmetit, i cili u dërgua nga Patrikana në Korçë në tetor të vitit 1922 dhe të Kristofor Kissit më prejardhje nga Berati, i thirrur nga ky Këshill në dhjetor të këtij viti. Duket se Patrikanës nuk i pëlqeu entuziazmi dhe pajtimi i Jerotheut me vendimet e Kongresit dhe e thirri menjëherë në Stamboll, bashkë me një komision prej katër mitropolitësh të kishës, për të biseduar për një rrugëzgjdhje të problemit kishtar.<sup>26</sup> Nga ky moment,

<sup>23</sup> *Po aty*; shih edhe dok. nr. 47, Telegram i Camadhos në Beograd për MPJ në Athinë, Beograd, 3 shtator 1924.

<sup>24</sup> *Po aty*.

<sup>25</sup> *Po aty*, dok. nr. 74, Telegram i MPJ për Administratën e Përgjithshme të Epirit, Athinë, 14 qershor 1925.

<sup>26</sup> *AIH*, A-V-230, A. Glavinas, *Kisha Ortodokse ...*, f.47.

Jerotheu u vu tërësisht në shërbim të politikës greke.<sup>27</sup> Ai influencoi edhe priftërinj të tjerë në Këshillin e Naltë, të cilët të prirur më shumë nga interesat personale se sa ato kombëtare, u bënë pengesa kryesore e këtij procesi.

Në respektim të vendimeve të Kongresit, puna filloi pikërisht në drejtim të plotësimit të vendeve vacantë të mitropolisë së Durrësit dhe të Gjirokastrës. U bënë përpjekje për gjetjen e dy peshkopëve të cilët do të miratonin dorëzimin (Hirotomini) peshkopal për peshkop të V. Xhuvanit, të cilin kongresi e kishte zgjedhur si zëvendësmitropolit të dioqezës së Durrësit.<sup>28</sup> Si mbështetës i autoqefalisë për afro tre vjet, ai nuk u lejua për të ushtruar këtë funksion në dioqezë dhe që ta përfaqësonte atë në Këshillën e Lartë.<sup>29</sup> Për dorëzimin e tij, fillimisht V. Xhuvani dhe qeveria, iu drejtuan Emzot Jerotheut, por ky nuk pranoi të vepronte pa marrë urdhër nga Patrikana. Ndërsa Emzot Kissi, deklaroi se nuk mund të dorëzonte asnjë peshkop pa bashkëmeshimin e Emzot Jerotheut dhe pa miratimin e Patrikanës.<sup>30</sup> Në këtë situatë, ata iu drejtuan At Vasil Markos i cili u shpreh se do të vinte në Tiranë për të dhënë pëlqimin. Kjo u konsiderua nga ana e V. Xhuvanit dhe qeverisë si aprovim dhe në maj 1925, ai mori gradën peshkopale prej dy peshkopëve ortodoksë të Kishës së Shenjtë sllave, ruse, në Savinë të Kotorrit.<sup>31</sup> Me dekretimin e tij si mitropolit të Durrësit, A. Zogu i jepte shtysë krijimit të Sinodit. V. Xhuvani ishte një klerik i përkushtuar, i cili do të bënte të mundur frenimin e propagandës greke dhe asaj vllahe (e cila ishte forcuar pas çeljes së konsullatës rumune në atë qytet), të cilat deformonin përkatësinë etnike të popullsisë ortodokse shqiptare.<sup>32</sup>

Gradimi dhe emërimi i V. Xhuvanit nuk u mbështet nga kryetari i Këshillës së Naltë At Vasil Marko, i cili, sipas Xhuvanit, për arsye personale, emëroi në vend të tij Vasil Rusin.<sup>33</sup> Kjo u dha zemër elementëve grekofilë dhe arumunë, të cilët duke ushtruar presion në

<sup>27</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου ...*, dok. nr. 79, Telegram i ambasadës greke për MPJ Athinë. Durrës, 5 shtator 1925.

<sup>28</sup> V. Xhuvani. *Kujtim vepre ...*, f.18.

<sup>29</sup> *Po aty*.

<sup>30</sup> *Po aty*, f. 24.

<sup>31</sup> *Po aty*, f. 28.

<sup>32</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: *F.*), viti (më tej: *V.*), dosja (më tej: *D.*) I-761, fl.2, Raport i Kryesisë së Republikës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Tiranë, 17 mars 1926.

<sup>33</sup> V. Xhuvani, *Kujtime vepre ...*, f. 27.

pleqësinë e dioqezës së Durrësit, nuk e pranuan V. Xhuvanin si drejtues të saj. Ata e justifikuan këtë qëndrim se ai ishte filoserb madje vunë në dyshim edhe moralin e tij.<sup>34</sup> Disa qarqe në diasporë ishin të paqartë për qëndrimin që A. Zogu do të mbante ndaj kishës dhe emërimit të V. Xhuvanit, e panë me dyshim. Gazeta “Dielli” shkruante se ai do t’i shërbente bashkimit të dioqezës së Durrësit me Patrikanën e Ipekut (Pejë) dhe caktimi i tij ishte si një lëshim për grekët që e ndihmuan A. Zogun për të ardhur në pushtet.<sup>35</sup>

Për t’u njohur me situatën në KOSH dhe për të qartësuar qëndrimin e autoriteteve të kishës ndaj Xhuvanit, A. Zogu thirri në audiencë At Vasil Markon.<sup>36</sup> Sipas shtypit, ai vuri theksin tek masat që duheshin marrë për rritjen e rolit të kishës në interes të çështjes kombëtare.<sup>37</sup> Qëndrimi i A. Zogut ndaj çështjes së kishës, inkurajoi klerikë të lartë të Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, si At Marko Kondili, Gaqo Suli, Gjergji Vulpe etj., t’i kërkonin Këshillës së Naltë, të përkrahte e të fuqizonte gjuhën shqipe në kishat e Shqipërisë. Ata gjithashtu i sugjeronin qeverisë shqiptare t’i jepte kishës mbështetjen morale.<sup>38</sup>

I ndodhur nën presionin e brendshëm dhe atë të jashtëm, veçanërisht të akuzave të kundërshtarëve politikë për shitjen e Vermoshit e të Shën Naumit dhe frika e tyre se mund të bënte konçesion edhe në çështjen e kishës, e shtyu A. Zogun të shfrytëzojë takimin e radhës me ambasadorin grek në Durrës, për të shfaqur hapur pikëpamjen e tij mbi autoqefalinë, për të cilën tashmë kishte nisur të vepronte.<sup>39</sup> Ai deklaroi se çështjen e kishës e kishte lënë në dorë të grekëve. Si kryepeshkop kishte emëruar Jerotheun dhe së shpejti do të dërgonte në Konstandinopojë një komision të kryesuar prej tij për bisedime me Patrikanën.<sup>40</sup> Por, meqënëse komunikata e fundit e saj, përmbante terma kufizuese në çështje të pavarësimit të kishës, A. Zogu kishte anuluar nisjen e tij. Zogu, theksonte diplomati grek, nuk dëshiron që komisioni të kthehet

<sup>34</sup> *Dielli*, nr. 2858 (411), 28 maj 1925. fl.1; *po aty*, nr.2873 (416), 11 qershor 1925, f. 2.

<sup>35</sup> *Po aty*, nr. 2858 (411), 28 maj 1925. fl.1; *po aty*, nr.2839) (382), 19 mars 1925, f. 2; V. Xhuvani, *Kujtime vepra ...*, f. 17.

<sup>36</sup> *Dielli*, nr. 2868(411), 28 maj 1925, f. 4.

<sup>37</sup> *Po aty*.

<sup>38</sup> *Po aty*, nr.2873 (416) 11 qershor 1925, f.3; *Gazeta Elbasani*, nr.45 (8) 31 korrik 1925, f.1.

<sup>39</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου ...*, dok. nr. 79, Telegram i Ambasadës greke për MPJ Athinë, Durrës, 5 shtator 1925.

<sup>40</sup> *Po aty*.

duarbosh. Ai kërkon që, në fillim Patrikana të deklarohet se ka vullnet për të diskutuar në lidhje me autoqefalinë, dhe më pas ato çështje të dorës së dytë mund t'i diskutonte e t'i zgjidhte me Jerotheun.”<sup>41</sup> Deklarimi i tij e shtyu ambasadorin grek t'i kujtonte Zogut se kjo ishte në kundërshtim me premtimin e tij në Beograd për korrigjimin e “gabimit” të shpalljes të autoqefalisë të KOSH.<sup>42</sup> Por, Zogu theksoi se: “Të gabuar nuk nënkuptonte Kishën Autoqefale me bekimin dhe pranimin e Patrikanës, por atë kishë që kishte ndërtuar F. S. Noli si instrument të tij.”<sup>43</sup> Ai shtoi se i kishte përmbushur premtimet e tij, madje dhe i kishte tejkaluar duke lejuar hapjen e shkollës Hieratike në Korçë.<sup>44</sup> Ndërsa për të gjitha kërkesat e tjera, i sugjeroi ambasadorit, t'i kanalizonin në rrugë zyrtare duke i paraqitur ato përmes deputetëve grekë në parlament dhe qeveri.<sup>45</sup> Gjithashtu i bëri të qartë se nuk do të lejonte çeljen e shkollave greke në Sarandë sepse ajo ishte zonë shqipfolëse. Ndërsa për privilegjet e Himarës që ngrinte pala greke, shtoi se ato në kohën e pushtimit osman i gëzonte edhe zona e tij e origjinës Mati, “...por është habi,- shtoi ai,- që himarjotët e ngrenë në një kohë që nuk u janë kërkuar taksa. Përcaktimi i përhershëm i këtyre privilegjeve do të bëhet në një kohë të mëvonshme”.<sup>46</sup>

Qartësimi politik ndaj kërkesave të Greqisë, i mundësoi Zogut, qeverisë e parlamentit, që në bashkëpunim me klerikë dhe laikë atdhetarë të çonin përpara procesin e pavarësimit të KOSH. Mbështetja e qeverisë inkurajoi elementin proautoqefalisë në Këshillin e Naltë, i cili në tetor 1925, me anë të një letre, u përgjigjeshin shqetësimeve të publikut, për çështjen e autoqefalisë së kishës dhe i siguronin se ideali i KOSH ka qenë dhe mbetet futja e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në kishat e Shqipërisë.<sup>47</sup> Zotoheshin se këtë rrugë do ta vazhdonin megjithë pengesat për sigurimin e mjeteve të duhura. “Nuk do ta lemë,- theksohej në letër,- që propogandat antikombëtare të përfitojnë me anë të kishës në dëm të saj

<sup>41</sup> *Po aty.*

<sup>42</sup> *Po aty.*

<sup>43</sup> *Po aty.*

<sup>44</sup> *Po aty.*

<sup>45</sup> *Po aty.*

<sup>46</sup> *Po aty.*

<sup>47</sup> *Dielli*, nr. 2921 (464), 3 tetor 1925, f.3, Letër e Këshillit të Naltë drejtuar gazetës “Dielli” nga Foqion Postoli. Letra mban datën 5 gusht 1925.

dhe të shtetit tonë<sup>48</sup> Për këtë mision të rëndësishëm, Këshilli i Naltë vlerësonte mbështetjen e A. Zogut i cili, në krye të shtetit shqiptar, kishte treguar kurdoherë me veprime të vyera dëshirën për stabilizimin e përparimin e Kishës Autoqefale Shqiptare mbi baza kombëtare.<sup>49</sup>

Pozicionimi i qeverisë kundër pretendimeve greke në Shqipërinë e Jugut dhe mbështetja që ajo i dha autoqefalisë së kishës, hasi në kundërshtimin e diplomatëve grekë në Shqipëri. Ata u përpoqën t'i jepnin këtyre veprimeve ngjyrimet fetare dhe t'i paraqisnin ato si një ofensivë të elementit mysliman, të favorizuar prej qeverisë, për të goditur interesat e elementit ortodoks në çështje të tilla si ajo e kishës, e shkollave greke, e pronave në Sarandë etj.<sup>50</sup> Grekët e konsideruan si të padrejtë ndërhyrjen e autoriteteve lokale të Korçës, tek mitropoliti i kishës për të meshuar në gjuhën shqipe.<sup>51</sup> Pretendimet e tyre u kundërshtuan nga prefekti i Korçës Hil Mosi. Ai e konsideronte autoqefalinë e kishës si një detyrë kombëtare legale, në pajtueshmëri me statutin e KOSH dhe me parimet e ungjillit i cili lejonte që, për interesat politike të çdo shteti të pavarur, kryesia fetare duhej të ishte e pavarur dhe lutjet fetare të kryheshin në gjuhën amtare.<sup>52</sup> Hil Mosi propozoi disa masa për ta çuar përpara procesin e pavarësimit: *së pari*, të ndaleshin përpjekjet e konsujve grekë të cilët, në rrugë jozyrtare, inkurajonin mësuesit privatë grekë për mësimin e gjuhës greke, duke i shpërblyer ata me viza për në Greqi. Gjithashtu këta mësues, në bashkëpunim me elementë brenda kishës, synonin të krijonin një shtet brenda shtetit; *së dyti*, transferimin e mitropolitit Jerotheos në Berat, sepse me qëndrimet e tij, në thelb antikombëtare, kishte cenuar autoqefalinë e kishës. Ai duhej të zëvendësohej me Emzot Kissi; *së treti*, të merreshin masa për krijimin e Sinodit me elementë kombëtarë, me qëllim që t'i jepej kishës një fizionomi në përputhje me interesat e shtetit. Gjithashtu duhej të largoheshin gradualisht elementët e dyshimtë, duke i zëvendësuar këta me klerikë të devotshëm, jo vetëm për çështjet fetare

<sup>48</sup> *Po aty*.

<sup>49</sup> *Po aty*.

<sup>50</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1926, D. 102. fl. 3, Telegram i Hysni Demës, Komandant i xhandarmërisë për zonën e Jugut, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Sarandë, 11.1.1926; Telegram i nënkonsullit grek në Sarandë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Sarandë, 9 maj 1925.

<sup>51</sup> *Po aty*, fl. 5, Telegram i prefekturës së së Korçës, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 9 prill 1926.

<sup>52</sup> *Po aty*.

por dhe ato kombëtare; *së katërti*, nga anëtarët e Sinodit (Jerotheos dhe Kissi) të kërkohej zbatimi i nenit 2 të statutit që i detyronte ata të punonin kombëtarisht pasi ndërhyrjet e huaja, veçanërisht ajo greke, kishin për qëllim të ngulnin rrënjë në qytetin e Korçës.<sup>53</sup>

A. Zogu dhe qeveria nuk i ndanë përpjekjet për të vënë në lëvizje elementët brenda vendit për ndërtimin institucional të kishës, nga veprimtaria diplomatike për marrjen e Tomosit nga Patrikana. Fillimisht duheshin marrë hapa në përmirësimin e marrëdhënieve me Greqinë e cila ishte e “zhgënjyer” dhe përbënte pengesën kryesore për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Në dhjetor 1925, A. Zogu dërgoi në Athinë deputetin Vasil Bamiha, me një mision tepër sekret. Qëllimi i tij ishte trajtimi i problemeve që qëndronin pezull midis Greqisë dhe Shqipërisë ndër të cilat, një vend të rëndësishëm zinte çështja e KOSH.<sup>54</sup> Misioni i Bamihas u favorizua nga ardhja në pushtet e gjeneralit Pangallos, me bashkëpunëtorët e tij Rufos etj., të cilët, ndryshe nga paraardhësit, vendosën të ndiqnin një politikë të re në marrëdhëniet me Shqipërinë. Në bisedimet me Bamihën, ata shfaqën dëshirën për të zgjidhur çështjet me Shqipërinë në mënyrë të tillë që të vendoseshin bazat e një miqësie të ngushtë dhe të përhershme.<sup>55</sup> Ata premtuan ndihmë në fushën e arsimit, premtuan se do të ndërprisnin procesin e shkëmbimit të popullsisë çame etj. Gjatë bisedimeve, Pangallos, me anë të një deklaratë, u njohu të drejtën myslimanëve të Epirit të larguar për shkaqe të ndryshme nga Greqia, për t’u kthyer në vendet e tyre dhe urdhëroi shpërndarjen e sillogjeve vorioepirote.<sup>56</sup> Nëpërmjet këtyre premtimeve, autoritetet greke synonin të tërhiqnin qeverinë shqiptare në zgjidhjen e çështjes së Kishës Ortodokse, në favor të tyre dhe të merrnin prej saj garanci, për çështjen e shkollave greke në Shqipëri. Tërheqja e grekëve nga kërkesa për të futur

<sup>53</sup> *Po aty*, Telegram i Prefektit të Korçës, drejtuar MPB, 9 prill 1926; *po aty*, fl. 2.

<sup>54</sup> *The National Archives, London*, Public Record Office (më tej: PRO), Foreign Office (më tej: FO) në *AIH*, FO 371/11203, Telegram i Ayres drejtuar sekretarit të jashtëm Austin Chamberlain, Durrës, 22dhjetor 1925; shih Beqir Meta, “Përpjekjet për konsolidimin e Kishës Autoqefale shqiptare sipas optikës së dokumentave britanike 1925-1928”, në *Studime historike*, 1-2, 2013; *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), V. 1926, D. 239, fl.21, Telegram i Mit’hat Frashërit drejtuar MPJ, Athinë 19 prill 1926

<sup>55</sup> *TNA*, FO 371/11203, Telegram i R. Parr drejtuar Chamberlain, Durrës, 10 mars 1926; shih B. Meta, “Përpjekjet për konsolidimin ...”, f. 70.

<sup>56</sup> *Po aty*, FO 371/11203, Sër Milne Cheetham drejtuar A. Chamberlain, Durrës, 3, 9 shkurt 1926; shih B. Meta, “Përpjekjet për konsolidimin ...”, f.68.

gjuhën greke edhe në shkollat shqiptare të Shqipërisë së Jugut, e lehtësoi A. Zogun dhe qeverinë shqiptare. Kështu ata garantuan palën greke për forcimin e arsimit në zonat e minoritetit, në respektim të nenit 6 të Deklaratës së Lidhjes së Kombeve për minoritetet. Kështu filloi diskutimi i çështjes e Kishës Ortodokse të Shqipërisë për të cilën, pala greke u zotua se do të ndikonte te Patrikana që të pranonte kërkesën për pavarësinë e saj, e cila, sipas tyre, ishte vendosur në mënyrë të “parregullt” në kongresin e Beratit. Por, nga ana tjetër kreu i qeverisë greke theksoi se ky do të mbetej thjesht një sugjerim dhe jo një angazhim për ta detyruar Patrikanën.<sup>57</sup> Gjithashtu udhëheqësit grekë prematuan se do të nxisnin Patrikanën, të dërgonte në Shqipëri një përfaqësues të saj, i cili, pas shqyrtimit të çështjes, do të hartonte një raport mbi bazën e të cilit do të merrej vendimi përfundimtar.<sup>58</sup> Megjithëse midis palëve nuk u arrit ndonjë marrëveshje konkrete për çështjet kryesore, veçanërisht për atë të kishës, misioni i Bamihës u konsiderua si një sukses diplomatik për qeverinë shqiptare. Kjo sepse u arrit të trajtoheshin çështje në interes të të dy palëve, u bënë premtime të cilat çuan në krijimin e një klime miqësore dhe ju hap rruga bisedimeve për përgatitjen dhe nënshkrimin e traktateve të nënshtetësisë, tregtisë, ekstradimit e konsullore.

Pas zgjedhjes në krye të Patrikanës Ekumenike të Patrikut Vasilios, Sinodi i Shenjtë vendosi të nisë bisedimet me qeverinë shqiptare. Në këto bisedime Fanari përfaqësohej nga Emzot Krisanthos (mitropoliti i Trapezundit), i cili në të njëjtën kohë, ndonëse jo zyrtarisht, përfaqësonte edhe Athinën zyrtare dhe fetare greke. Në prill të këtij viti, Patrikana i dërgoi A. Zogut një telegram ku i kërkonte që t’i krijoheshin kushte të deleguarit të saj, për të studiuar situatën në KOSH. Në bazë të raportit të hartuar prej tij, ajo do të orientohej për një zgjidhje sa më të mirë të çështjes kishtarë në Shqipëri.<sup>59</sup>

Roli ndërmjetësues i Greqisë, nuk u prit mirë nga ministri Mit’hat Frashëri në Athinë. Në takimin me ministrin Rufos ai, theksoi se marrëdhëniet e KOSH me Patrikanën, para së gjithash, kishin të bënin me rregulla e norma fetare dhe angazhimi i qeverisë greke ishte i

<sup>57</sup> TNA, FO 371/ 11203, R. Parr drejt Chamberlaine, Durrës, 10 mars 1926; shih B. Meta, “Përpjekjet për konsolidimin...”, f.70.

<sup>58</sup> TNA, FO 371/ 11203, R. Parr drejt Chamberlaine, Durrës, 10 mars 1926.

<sup>59</sup> AMPJ, V.1926, D. 239, fl.28, Telegram i Patrikanës Ekumenike, Patriarku Vasilios, drejtuar A. Zogut, Kostandinopojë, 13 prill 1926. Për këtë, qeveria shqiptare mori njoftim edhe nga Legata shqiptare në Athinë.

panevojshëm, aq më tepër kur një gjë e tillë nuk ishte kërkuar nga ndonjë institucion fetar apo shtetëror në Shqipëri. Shqetësimin e tij, ai ia përcolli edhe kryeministrit Pangallos. Sipas tij, hyrja në mes e Greqisë rrezikonte që për mosmarrëveshjet midis Shqipërisë dhe Patrikanës, përgjegjëse të bëhej Athina e cila do të dyshohej se kishte kurdisur intriga. Këto dyshime do të bëheshin shkak për prishjen e marrëdhënieve ndërshtetërore.<sup>60</sup> Pangallos, për të qetësuar M. Frashërin, u mundua t'a paraqitete ndërhyrjen e Athinës jo si politikë parësore të Greqisë, por si pasojë e një konflikti midis Ministrisë së Jashtme dhe gjeneralit Kondulis.<sup>61</sup>

Vizitës së Krisanthos në Shqipëri i bëri jehonë edhe shtypi grek, në faqet e të cilit u trajtua e gjithë problematika e çështjes kishtare dhe ju dha mbështetje synimimeve të politikës greke për të siguruar një protektorat ndaj kishës ortodokse të Shqipërisë. Shtypi grek kritikoi vendimet e Kongresit të Beratit dhe të Këshillit të Naltë të kishës për shqipërimin tërësor të ungjillit dhe lutjeve fetare.<sup>62</sup> Goditjet e tij u përqendruan mbi politikën e shtetit shqiptar në mbrojtje të autoqefalisë dhe në fushën e arsimit në minoritetin grek. Në telegramin drejtuar Tiranës, M. Frashëri, e konsideronte qëndrimin e shtypit më tepër politik se sa fetar. “...ju bëj të njohur,- theksonte ai,- se kjo fushatë e shtypit këtu, sikundër kuptohet është e huaj me misionin e shenjtërisë së tij Krisanthos në Shqipëri”<sup>63</sup>.

Në maj të vitit 1926, qeveria shqiptare ngriti një komision të posaçëm për bisedimet me të derguarin e Patrikanës, duke i dhënë çështjes rëndësinë e duhur dhe duke synuar zgjidhjen e saj, sa në përputhje me rregullat kishtare aq dhe me interesat kombëtare.<sup>64</sup> Bisedimet e pritshme, vunë në lëvizje klerikët patriotë ortodoksë brenda dhe jashtë kishës. Veçanërisht aktive u tregua prefektura e Korçës e cila, në bashkëpunim me klerikë të Këshillës së Naltë, i paraqitën komisionit

<sup>60</sup> *Po aty*, fl. 21, Telegram i M. Frashërit drejtuar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 19 prill 1926.

<sup>61</sup> *Po aty*.

<sup>62</sup> *Po aty*, V. 1926, D. 239, Telegram i legatës shqiptare në Athinë, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 4 maj 1926.

<sup>63</sup> *Po aty*.

<sup>64</sup> *Po aty*, fl.38, Telegram i Ministrisë së Jashtme, drejtuar Shënjtërisë së tij Patriarkut Ikumenik në Stamboll, Tiranë, 7 qershor 1926.

disa propozime konkrete, për t'i patur parasysh në punën e tij.<sup>65</sup> Në mënyrë të veçantë u ndalën tek përzgjedhja e emrave për anëtarë të Sinodit të kishës. “Në interes të kishës dhe të kombit, shprehej H. Mosi, ishte përzgjedhja e elementëve nacionalistë të mirë, me të gjitha cilësitë e nevojshme, në mënyrë që në Sinod të mbizotëronte elementi kombëtar”.<sup>66</sup> Nëse kjo nuk do të arrihej me mitropolitët në Sinodin ekzistues (dy prej të cilëve pengonin autoqefalinë), ata propozonin që në statutin e përhershëm, i cili do të hartohej dhe miratohej nga Asambleja Kombëtare e Kishës, të sanksionohej që si pjesëtarë të Sinodit të pranoheshin, veç peshkopëve, edhe klerikë të tjerë, duke i hapur rrugë futjes së klerikëve kombëtarë me tituj të lartë. Një eksperiencë e tillë ishte aplikuar për formimin e Sinodit në kishën e Malit të Zi, në atë të Jeruzalemit etj. Për arritjen e këtij qëllimi, ata kërkonin edhe angazhimin e strukturave shtetërore, qoftë edhe indirekt, për përzgjedhjen e asamblistëve me cilësi të duhura, të cilët do të merrnin vendime në interes të kishës dhe të kombit shqiptar.<sup>67</sup> Veç kësaj, ata sugjeronin që në formimin e Sinodit peshkopal duhej të ruhej një vend i posaçëm për kryetarin aktual të Këshillës së Naltë me titullin Kryekonom (Ekonomi Mitruar).<sup>68</sup>

Në fillim të majit Emzot Krisanthos mbërriti në Durrës. Ministri grek Kondulis, i parashikonte bisedimet shumë të vështira, sepse sipas tij, qeveria shqiptare në diskutimet e fundit me të, ishte treguar e papajtueshme me çdo çështje, përfshirë edhe atë të kishës.<sup>69</sup> Megjithë pesimizmin e Kondulisit, bisedimet u konkretizuan me nënshkrimin e një marrëveshjeje më 6 qershor, që u quajt Akordi i Tiranës i cili, pasi u miratua nga qeveria shqiptare, më 7 qershor iu dërgua Patrikanës.<sup>70</sup>

Gjatë bisedimeve për çështje të caktuara pati kundërshtime nga të dyja palët. Për pikën 1 të Akordit, e cila përcaktonte numrin e anëtarëve të Sinodit u zhvilluan shumë debate. Komisioni këmbënguli të ruante numrin prej katër anëtarësh të vendosur në Berat dhe të ruhej vendi i kryetarit të Këshillës së Naltë me titullin Kryekonom. Kjo u bë për arsye

<sup>65</sup> *Po aty*, fl. 36, Telegram i prefektit të Korçës, Hil Mosi, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Korçë, 1 qershor 1926.

<sup>66</sup> *Po aty*.

<sup>67</sup> *Po aty*.

<sup>68</sup> *Po aty*.

<sup>69</sup> TNA, FO 371/11203, Telegram R. Parr drejtuar A. Chamberlain. Durrës 4 prill 1926.

<sup>70</sup> AMPJ, V. 1926, D.239, f.38, Telegrami Ministrisë së Jashtme, drejtuar Shenjtërisë së tij Patriarkut Ekumenik në Stamboll. Tiranë 7. 6 1926. Teksti i Akordit Të Tiranës.

të mungesës së klerikëve të lartë e të arsimuar shqiptar dhe për të penguar Patrikanën dhe kishën greke që të caktonin peshkopë grekë në krye të kishës. Kjo nuk u pranua nga Emzot Krisanthos, i cili propozoi 5 anëtarë të Sinodit, me arsyetimin se krijimi i kishës me 4 anëtarë do t'i krijonte mundësi kryepeshkopit që, me mbështetjen e njërit prej anëtarëve të Sinodit, t'u impononte vullnetin e tij ortodoksëve të Shqipërisë.<sup>71</sup> Sipas tij, kjo do t'i hapte rrugë mosmarrëveshjeve të brendshme dhe ndikimeve të jashtme që do t'i sillnin kishës çregullime dhe përçarje.<sup>72</sup> Për komisionin qeveritar bisedimet u vështirësuan sepse ai kishte parashikuar edhe emrat e anëtarëve. Edhe në këtë çështje përfaqësuesi i Patrikanës nuk ra dakord me komisionin. Ai propozoi, që tre prej anëtarëve të Sinodit të përzgjidheshin nga një listë me 8 klerikë të paraqitur nga Patrikana.<sup>73</sup> Kërkesa e tij u kundërshtua nga Hysen Vrioni, me pretendimin se komuniteti ortodoks shqiptar nuk i kishte mundësitë për të nxjerrë një numur kaq të lartë peshkopësh. Krisanthos e mbrojti pikëpamjen e tij duke iu referuar Kongresit të Beratit i cili parashikonte që për zbatimin e vendimeve të tij, mangësitë e kishës për klerikë mund të plotësoheshin me klerikë grekë. Ai tha se për këtë qëllim nuk kërkoi anulimin e Kongresit të "parregullt" të Beratit dhe disa veprime antikanonike të kishës.<sup>74</sup>

Mbështetur në pikat e marrëveshjes, del se komisioni, për të mundësuar përfundimin e bisedimeve, pranoi shtimin e një anëtari në numrin prej 4 anëtarësh të Sinodit dhe hodhi poshtë propozimin për përzgjedhjen e tre peshkopëve i cili do t'i krijonte mundësi Patrikanës dhe kishës greke që të ndërhynte në çështje e brendshme të kishës.

Emërimi i mitropolitëve për Gjirokastrën, Durrësin dhe Tiranën do të bëhej nga Patrikana dhe Sinodi i Shenjtë, por ata do të përzgjidheshin nga emrat e propozuar nga Komisioni i Posaçëm Ortodoks Shqiptar i emëruar nga qeveria. Ndërsa për fronet e mitropolisë së Korçës e asaj të Beratit iu la e drejta Patrikanës për të emëruar, me një akt sinodik të posaçëm, peshkopët ekzistues. Pranimi i këtij kompromisi nga pala shqiptare u bë për shkak të dëshirës për të mos zgjatur më tej bisedimet. Efektet negative që mund t'i shkaktoheshin kishës nga ky kompromis, Komisioni

<sup>71</sup> TNA, FO 371/11203, O'Reilly drejtuar A. Chamberlain, Durrës, 1 qershor 1926; B. Meta, "Përpyekje për konsolidimin e KOASH ...", f.74.

<sup>72</sup> Po aty.

<sup>73</sup> Po aty.

<sup>74</sup> Po aty.

parashikonte t'i neutralizonte me statutin e ri që do të hartohej nga Asambleja e re dhe me legjislacionin shtetëror që do të miratohej.

Në pikën 4 të Akordit theksohej se adhurimi i shenjtë i Zotit në kishat shqiptare do të kryhej në gjuhën shqipe. Në këtë gjuhë do të përktheheshin apostulli, paqësorët, ungjilli, literatura kishtare etj., që do të miratoheshin prej Sinodit të kishës.<sup>75</sup> Në akord u pranua që shteti shqiptar t'i jepte pavarësinë dhe lirinë e plotë kishës për zhvillimin e jetës fetare, kishtare, në krijimin e institucioneve kulturore dhe seminareve.<sup>76</sup> Akordi i njihte liri të plotë minoritetit grek në Shqipëri për të zhvilluar fenë, gjuhën, arsimin dhe filantropinë.<sup>77</sup> Në pikën A të Akordit, sanksionohej numri i kandidaturave për vendet bosh të tre dioqezave dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre. Mbështetur në pikën 1 dhe 2 të Akordit, Komisioni i kushtoi rëndësi përzgjedhjes së katër kandidaturave për mitropolitë. U përzgjedhën mitropoliti i Triqesë, me origjinë nga Përmeti, mitropoliti i Pelagonisë së Re, Joaqim, Evllogjia Korillas, sekretar i manastirit të Shenjtë të Llavrios në rajonin e Agjion Oros dhe peshkopi Kotoko.<sup>78</sup> Sipas ligjeve kanonike, Patrikana do të zgjidhte tre prej tyre. Në pikën B përcaktohej se, nëse detyra do të refuzohej prej dy të propozuarve, atëherë Komisioni i posaçëm, kishte të drejtë të propozonte kandidaturën e tretë.<sup>79</sup> Me përfundimin e Akordit të Tiranës, Emzot Krisanthos nuk arriti të realizonte qëllimet e tij. Megjithatë, ai kishte bindjen se fjala e fundit i takonte Patrikanës.<sup>80</sup> Akordi i Tiranës ishte një dokument i rëndësishëm i cili, duke iu përmbajtur rregullave kanonike, ruante marrëdhëniet shpirtërore të kishës ortodokse shqiptare me Patrikanën dhe, në të njëjtën kohë, jetësonte autoqefalinë dhe rregullonte raportet e saj me institucionet shtetërore.

Bashkë me Akordin, A. Zogu, i drejtoi një letër Patrikut Ekumenik, në të cilën theksonte :“ Në letrën që hirësia Juaj më dërgonte më 13 prill, shfaqnit dëshirën që t'i jepnit një përfundim çështjes së kishës ortodokse shqiptare. Duke siguruar shenjtërinë tuaj që kjo dëshirë është edhe imja

<sup>75</sup> AMPJ, V.1926, D. 239, fl.38, Telegram i Ministrisë së Jashtme drejtuar Shënjtërisë së tij, Patriarkut Vasilio, Stamboll, Tiranë, 7 qershor 1926.

<sup>76</sup> Po aty.

<sup>77</sup> Po aty.

<sup>78</sup> Po aty.

<sup>79</sup> Po aty.

<sup>80</sup> TNA, FO 371/11203, Telegram i O'Reilly, drejtuar A. Chamberlain, Durrës, 24 qershor 1926.

dhe e qeverisë s'eme, ju njoftoj se, me anë të Hirësisë së tij, Emzot Krisanthos, qeveria po ju dërgon vendimin e marrë mbi këtë çështje prej komisionit të posaçëm së bashku me Emzot Krisanthos për zgjidhjen e mirë të së cilës, nuk kam dyshimin që edhe shenjtëria Juaj do të tregojë vullnetin më të mirë”<sup>81</sup>

Patrikanës nuk i pëlqeu Akordi i Tiranës dhe nuk i ktheu përgjigje qeverisë shqiptare, me justifikimin se ishte e angazhuar në përgatitjet për njohjen e autoqefalisë së kishës së Dodekanezit.<sup>82</sup> Në fillim të nëntorit, N. Leskoviku, ishte informuar nga burime brenda Sinodit se në të njëjtën mbledhje Patrikana do të lëshonte edhe vërtetimin për autoqefalinë e kishës ortodokse të Shqipërisë.<sup>83</sup> Por me 11 janar 1927, ai njoftonte sërish se Patriku ende nuk ia kishte komunikuar lejen e pavarësimit të kishës.<sup>84</sup> Meqë Patrikana, pa asnjë arsye të qenësishme po vononte lëshimin e Tomit, Ministri i Jashtëm Hysen Vrioni, udhëzoi legatën shqiptare në Athinë të takonte Emzot Krisanthos dhe të merrte sqarime për pengesat që po krijoheshin për zgjidhjen e çështjes së kishës. Nëse konstatonte ndonjë pengesë zyrtare të Athinës, legata duhej të bënte të gjitha veprimet verbale për të shpejtuar lëshimin e Tomosit.<sup>85</sup>

Interesimi dhe shqetësimi i qeverisë shqiptare vuri në lëvizje Patrikanën e cila vendosi t'i kërkonte Tiranës ridiskutimin e çështjes së kishës me ndërmjetësinë e legatës greke.<sup>86</sup> Edhe Emzot Krisanthos në Athinë ishte shprehur se Tomosi do të lëshohej pas nënshkrimit të një protokollit, për të cilën priste instruksione nga Patrikana, para se të vinte në Shqipëri.<sup>87</sup> Këto qëndrime provonin se Patrikana kishte si qëllim të rikthente nga fillimi diskutimin e çështjes.

<sup>81</sup> AMPJ, V. 1926. D. 239, fl. 13, Letër e Presidentit të Republikës, drejtuar Shkëlqesisë së Tij Patriarkut Ekumenik në Stamboll, Tiranë, më 7 qershor 1926.

<sup>82</sup> Po aty, fl.57, Telegram i konsullit N.Leskoviku, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Stamboll, 30 tetor 1926.

<sup>83</sup> Po aty, fl.58, Telegram i N.Leskovikut drejtuar Ministrit të Jashtëm H.Vrioni. 3 nëntor 1926.

<sup>84</sup> AMPJ, V.1927, D. 238, fl.1, Telegram i N.Leskovikut drejtuar Ministrisë së Jashtme, Stamboll, 11 janar 1927.

<sup>85</sup> Po aty, fl.2, Telegram i Ministrisë së Jashtme, drejtuar legatës shqiptare në Athinë, Tiranë, 16 janar 1927.

<sup>86</sup> Po aty, fl.3, Telegram i N. Leskovikut, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Stamboll, 18 janar 1927.

<sup>87</sup> Po aty, fl.5, Telegram i legatës shqiptare në Athinë, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 23 janar 1927.

Më 22 janar Patrikana, njoftoi për dërgimin në Tiranë të Emzot Krisanthos, për t'i dhënë zgjidhje të pëlqyeshme çështjes së kishës, bashkë me qeverinë shqiptare, sipas projekt-protokollit të dërguar prej saj.<sup>88</sup> Sipas Patrikut, projekti ndryshonte nga Akordi i Tiranës vetëm në një artikull, në atë të zgjedhjes dhe emërimit nga ana e saj të peshkopit të Tiranës, me justifikimin se Selia e Shenjtë donte të sigurohej që kisha të fillonte jetën nën drejtimin e një njeriu të aftë.<sup>89</sup> Protokollin i paraqitur nga Krisanthos ishte në gjuhën greke dhe jo në frëngjisht në të cilën shprehej zakonisht korrespondenca zyrtare e Patrikanës me qeverinë shqiptare, ç'ka linte të kuptohej se protokollin ishte përgatitur në Athinë. Qeveria shqiptare i kërkoi Komisionit të Posaçëm, të përgatitej seriozisht për bisedimet e pritshme.<sup>90</sup> Nisur nga rëndësia që kishte çështja e kishës, në komision u zgjodhën deputetë e senatorë si Kostaq Kote (Kryetar i Dhomës së Deputetëve) senatorët Andon Beça e Spiro Papa dhe deputetët Mihal Kaso, Vasil Ruci, dr. Simonidhi dhe Vasil Bamiha. Komisioni kryesohej nga kryetari i Senatit, Pandeli Evangjeli. Në komision u shfaqën kundërshti lidhur me procedurën për shqyrtimin e projekt-protokollit.<sup>91</sup> Shumica e komisionit gjykoj se projekti ishte në shkelje të plotë të Akordit të Tiranës dhe u shpreh për refuzimin e tij. Ata i kërkuan qeverisë të mbështeste autoqefalinë e kishës sipas marrëveshjes së 6 qershorit 1926, e cila ishte pranuar dhe nënshkruar nga të dy palët. Në bazë të saj, Patrikana duhej të lëshonte Tomosin. Ndryshimi i qëndrimit të Patrikanës kishte tronditur sinqeritetin dhe besimin e komisionit për vijimin e bisedimeve me delegatin e saj.<sup>92</sup> Protokollin, ndonëse nuk bënte ndryshime në dispozitat shpirtërore të Akordit të Tiranës, ndërhynte dhe ndryshonte dispozitat administrative, politike e juridike të tij. Zbatimi i tyre nga Sinodi kishtar, pavarësisht nga përbërja e tij, krijonte në Republikën e Shqipërisë një shtet fetar i cili do të administronte nënshtetasit shqiptarë ortodoksë sipas rregullave e organizimeve të diktuar nga Patrikana, si në çështjet juridike, në të drejtën e trashëgimisë

<sup>88</sup> *Po aty*, fl.6-7, Telegram i Patriarkut Vasilios, drejtuar Kryetarit të Republikës, A. Zogu, Stamboll, 22 janar 1927.

<sup>89</sup> *Po aty*, fl.14, Telegram i N. Leskovikut, drejtuar MPJ, Stamboll 17 janar 1927; *TNA*, FO 371/12069, Telegram i Seeds drejtuar A. Chamberlain, Durrës, 2 shkurt 1927.

<sup>90</sup> *AMPJ*, V.1927, D 238, fl.13-14.

<sup>91</sup> *Po aty*, fl.30-44, Diskutime për projektprotokollin e paraqitur nga Patrikana.

<sup>92</sup> *Po aty*, Raport i 5 anëtarëve të komisionit për projektprotokollin drejtuar Ministrisë së Jashtme, Tiranë, 17 shkurt 1927.

me testament, etj.<sup>93</sup> Gjithashtu ai krijonte në Shqipëri, klasën e privilegjuar të klerit ortodoks me imunitet penal e civil, duke i mohuar shtetit shqiptar të drejtën e vetos. Ai e detyronte qeverinë që, me anë të një deklarate të depozituar në Lidhjen e Kombeve, të pranonte projekt-protokollin, rolin e Patrikanës ashtu dhe Tomosin e dhënë, duke pranuar një minoritet allofil të shtypur prej shtetit shqiptar dhe rolin mbrojtës të Patrikanës.<sup>94</sup> Mbështetur në analizën e neneve të projekt-protokollit, Komisioni arriti në përfundimin se, me anë të tyre, Patrikana ndërhynte në administrimin e brendshëm të kishës dhe në lirinë sociale e shtetërore të Shqipërisë. Në këtë mënyrë “Patrikana, duke mbajtur në njërin dorë shpatën ngritur dhe dorën tjetër të shtrirë, është duke i thënë kishës shqiptare ose bëj si të them unë ose të mora Tomosin”.<sup>95</sup>

Edhe përfaqësuesi anglez në Durrës, i cili ndiqte me interes bisedimet midis qeverisë shqiptare dhe Patrikanës, e konsideroi projektin e ri si forcim të autoritetit të Patrikanës mbi kishën autoqefale të Shqipërisë.<sup>96</sup> “Amandamentet e tij,- theksonte ai,- ishin dukshëm vepër e juristëve grekë të së drejtës fetare, të cilët i kishin bazuar propozimet e tyre në privilegjet që gëzonte Patrikana në kohët e këqia e të vjetra të Kalifatit”.<sup>97</sup>

Kundër mendimit të shumicës, dolën dy anëtarë të Komisionit, dr. Simonidhi e Mihal Kaso. Ata kërkuan që projekt-protokolli të pranohej në parim, e më pas të diskutohej nen për nen dhe duke u bazuar në vendimet e Kongresit të Beratit dhe në rregulloren e miratuar prej tij, të bëheshin rregullimet e nevojshme.<sup>98</sup> Me sa duket, të ndikuar nga politika greke, ata synonin të fusnin në diskutim çështje të cilat Patrikana dhe qeveria greke do t'i zvarrnisnin pa fund, për ta shtyrë qeverinë shqiptare drejt kompromisit në çështjet themelore të kishës. Qeveria shqiptare u pajtua me mendimin e shfaqur nga shumica dhe vendosi të mos pranonte

<sup>93</sup> *Po aty*, fl. 32.

<sup>94</sup> *Po aty*.

<sup>95</sup> *Po aty*, fl.35, Raport i pesë anëtarëve të komisionit për diskutimin e projekt-protokollit.

<sup>96</sup> *TNA*, FO 371/12069, W. Seeds drejtuar A. Chamberlain, Durrës, 5 mars 1927; shih edhe B. Meta, *Autoqefalia e kishës ...*, f. 80.

<sup>97</sup> *Po aty*.

<sup>98</sup> *AMPJ*, V.1927, D.238, fl. 38-40, Raport mbi diskutimet në komision drejtuar Ministrisë së Jashtme, Tiranë, 17 shkurt 1927.

diskutimin e projekt-protokollit. Në këtë mënyrë bisedimet u ndërprejnë dhe Emzot Krisanthos u largua nga Shqipëria.

Megjithë dështimin që pësoi, Patrikana ishte e prirur të vazhdonte përpjekjet për ta futur çështjen përsëri në rrugën e bisedimeve. Ajo i kërkoi Tiranës t'i dërgonte me shkrim pikat e kundërshtuara nga Komisioni, për të cilat ajo do të kthente përgjigje me shkrim.<sup>99</sup> Këshilli i Ministrave, pasi vlerësoi se amendamentet e projektit ishin në kundërshtim me interesat e shtetit shqiptar, vendosi ta refuzonte atë.<sup>100</sup> Ministri i Jashtëm e njoftoi Patrikanën për vendimin e qeverisë. Ai i dërgoi Patrikanës një promemorie në të cilën evidentoheshin artikujt e projekt-protokollit që binin ndesh me Akordin e Tiranës dhe i kërkonte asaj të shprehej me shkrim.<sup>101</sup>

Zhvillimet e fundit në çështjen e kishës u pasqyruan edhe në shtypin e kohës. “Gazeta e Korçës” i bënte të ditur Patrikanës dhe mbështësve të saj se “tërë populli ortodoks shqiptar kurrë më nuk vë përpara interesave kombëtare interesat fanatiko -fetare, që nuk janë të bashkuara me interesat e shtetit”.<sup>102</sup> Gjithashtu, kjo gazetë përshëndeti qëndrimin e qeverisë dhe të Komisionit për zbatimin e Akordit të Tiranës. “Le ta dijë Patrikana, se ne, fenë tonë ortodokse e kemi, e ruajmë e nderojmë dhe s’na i takon njeri, se do të mundim të vazhdojmë së foluri si ortodoksë dhe se i zgjidhim të gjitha çështjet dhe pa bekimin e kishës hije të institutës së madhe”.<sup>103</sup>

Në fillim të marsit, P. Evangjeli dha një intervistë për shtyp duke bërë të njohur qëndrimin e qeverisë për çështjen e kishës dhe për të davarituar paqartësitë dhe dyshimet që ishin krijuar rreth saj. Ai theksoi, se Komisioni i posaçëm ishte i vendosur që çdo marrëveshje kishtarë në të ardhmen, do të bëhej vetëm mbi bazën e Akordit të qershorit 1926. Ndërsa projektin e Patrikanës e quajti përgjithësisht të papranueshëm dhe krejt të papritur. Ai pohonte: “kurrë nuk mund t’i shkonte mëndja njeriu që të parashtrohej një gjë e tillë për diskutim”.<sup>104</sup> Evangjeli

<sup>99</sup> *Po aty*, fl. 27, Telegram i N. Leskovikut, drejtuar MPJ, Stamboll, 23 shkurt 1927; *po aty*, fl.25, Letër e Patriarkut, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Stamboll, 1 mars 1927.

<sup>100</sup> *Po aty*, fl. 28, Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 72, Tiranë, 24.2.1927.

<sup>101</sup> *Po aty*, fl. 36-37, Promemorie.

<sup>102</sup> “Dredhitë e Patrikanës”, në *Gazeta e Korçës*, nr.355, 22 shkurt 1927.

<sup>103</sup> *Po aty*, f.4.

<sup>104</sup> *Gazeta e Korçës*, nr.358, 8 mars 1927, f.1. Intervistë e Pandeli Evangjelit, kryetar i komisionit të posaçëm, mbi autoqefalinë e KOSH dhe qëndrimin e Patrikanës.

paralajmëronte se, nëse Patrikana nuk do të tërhiqej nga projektprotokolli, Komisioni dhe qeveria do ta zgjidhin çështjen në mënyrë të njëanshme. “Do t’i përvishemi vetë punës,- theksoi ai,- dhe do të organizojmë kishën tonë autoqefale kombëtare, që të bëhet si shembulli më i mirë.”<sup>105</sup> Sipas tij, çështja e kishës ishte futur në rrugën e zgjidhjes sepse për organizimin e saj dhe, në pajtim të plotë me prestigjin e shtetit të pavarur shqiptar, komisioni kishte hedhur hapa në këtë proces, duke vendosur kontakte me personat e propozuar për anëtarë të Sinodit të cilët kishin dhënë pëlqimin e tyre.<sup>106</sup> Ndërsa lidhja e saj me Patrikanën do të vazhdonte në aspektin shpirtëror dhe dogmatik, ashtu siç ishte vepruar edhe me kishat e tjera autoqefale.

P. Evangjeli i kushtoi vëmendje përdorimit të gjuhës shqipe në shërbesat kishtare të kishave ortodoke në Shqipëri. Ai u shpreh se çështja e gjuhës ishte një nga pikat e Akordit dhe nuk kishte pengesa për përdorimin e saj në shërbimin kishtar. Ai sqaroi se meshimi në gjuhën greke në disa kisha ishte i përkohshëm, deri sa librat e përkthyer në gjuhën shqipe të bekoheshin e miratoheshin nga Sinodi shqiptar. Qeveria shqiptare do të priste përgjigjen nga Patrikana deri në prag të pashkëve, siç kishte premtuar Krisanthos, në të kundërt do të formonte një komision i cili do të përkujdesej për formimin e Sinodit dhe për të gjitha çështjet e ekzistencës së kishës shqiptare.<sup>107</sup>

Qëndrimi i vendosur i qeverisë shqiptare në zgjidhjen e çështjes kishtare dhe në çështjet e tjera të pretenduara nga grekët, i shtynë ata të bënin presione gjithfarësh. Athina zyrtare, shkoi aq larg sa kërcënoi se ishte e gatshme të përdorte të gjitha mjetet, përfshirë edhe ndërhyrjen ushtarake në ruajtje të interesave të saj.<sup>108</sup> Por pas nënshkrimit të Paktit të Parë të Tiranës dhe mbështetjes që Italia i dha qeverisë shqiptare në qetësimin e situatës brenda vendit, pozita e Zogut u forcua. Kjo i krijoi atij mundësi për t’i shkuar deri në fund dhe pa kompromis, çështjes së pavarësimit të Kishës Ortodokse Shqiptare dhe çështjeve të tjera në marrëdhëniet me Greqinë dhe Patrikanën.

Patrikana, në pamundësi për të thyer vullnetin e qeverisë shqiptare dhe të mbështetësve të saj, në fillim të majit, deklaroi se hiqte dorë nga

<sup>105</sup> *Po aty.*

<sup>106</sup> *Po aty.*

<sup>107</sup> *Po aty.*

<sup>108</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου ...*, dok. nr. 102, Telegram i ambasadorit grek drejtuar Ministrisë së Jashtme, Tiranë, 1 mars 1927.

projekt-protokolli, duke u justifikuar se nuk kishte pasur si qëllim të anashkalonte marrëveshjen e Tiranës, por ishte udhëhequr nga dëshira dhe kujdesi i posaçëm për rregullimin sa më mirë të punëve të kishës. Gjithashtu, ajo njoftonte se Sinodi i Shenjtë, kishte shfaqur mendimin se ishte e mundur t'i akordohej autoqefalia kishës shqiptare, duke u mbështetur vetëm në Akordin e Tiranës.<sup>109</sup> Pas përgjigjes së qeverisë shqiptare, ajo bashkë me Sinodin do të fillonte procedurën për organizimin kanonik të kishës.<sup>110</sup>

Por premtimet e deklarimet e saj mbetën përsëri në letër, pasi nuk u hodh asnjë hap tjetër për zbatimin e tyre konkret. Duke paraqitur herë pas here justifikime, Patrikana synonte të shtynte sa të ishte e mundur lëshimin e Tomosit, të lodhte qeverinë shqiptare dhe të fitonte kohë që, në një situatë të favorshme, t'i impononte popullit shqiptar vullnetin e saj.<sup>111</sup> Kështu, Patrikana, i dërgoi konsullit shqiptar në Stamboll dy letra, në të cilat theksohej se ajo, para njohjes zyrtarisht të autoqefalisë dhe para se të jepte Tomosin, duhej të merrte mendimin e qeverisë shqiptare për pavarësinë e plotë të kishës. Për këtë, qeveria shqiptare duhej të dërgonte një komision të ri në Stamboll për të nënshkruar Akordin e Tiranës.<sup>112</sup> Duket se Patrikana synonte ta zvarste zgjidhjen e problemit, pasi shpresonte që një komision me emra të rinj, mund të ndikonte në ndryshimin e qëndrimit të qeverisë për emrat e klerikëve që do të propozoheshin për kreun e kishës. Në këtë mënyrë çështja kishtarë do të futej në një rrugë pa krye. Gjithashtu, N. Leskoviku shkruante se Patrikana synonte të shkëpuste prej konsullatës edhe disa të holla më shumë nga sa kujtonte se do të merrte.<sup>113</sup> Kërkesën e pakuptimtë të Patrikanës, qeveria shqiptare e priti me indiferencë. Ndërkohë, bashkë me Komisionin e Posaçëm dhe klerin ortodoks qeveria e përqendroi vëmendjen tek përzgjedhja e kandidaturës për postin e kryetarit të kishës. “Kryetari i kishës, theksonte gazeta “Telegraf”,- veç cilësive të tjera që i

<sup>109</sup> AMPJ, V.1927, D.238, fl. 27, Telegram i N. Leskovikut drejtuar Ministrisë së Jashtme, Stamboll, 23 shkurt 1927; *po aty*, fl. 25, Letër e Patriarkut Ekumenik, drejtuar konsullit shqiptar në Stamboll, N. Leskoviku, Stamboll, 19 maj 1927.

<sup>110</sup> *Po aty*.

<sup>111</sup> *L'eglise Autocephale Orthodoxe D'Albanie*, Imprimerie Albert Koding, Genevë: 1929, f.32.

<sup>112</sup> *Po aty*, fl.52-54, Telegram i N. Leskovikut, drejtuar MPJ në Tiranë, Stamboll, 20 maj 1927.

<sup>113</sup> *Po aty*.

përkisnin ofiqit të tij të lartë, duhej të inspirojë besim për veprimin e tij kombtar.”<sup>114</sup> Komisioni i Posaçëm, bashkë me Këshillën e Naltë shqyrtuan si kandidatura për kryetar të kishës, Emzot Joakimin dhe Emzot Kurillën.<sup>115</sup>

Ndërkohë edhe Patrikana, e mbështetur nga Peshkopata greke dhe nga elementët filogrekë në radhët e klerikëve ortodoksë shqiptarë, bëri të gjitha përpjekjet për kapjen e Sinodit dhe postit të Kryetarit të kishës. Nëpërmjet Krisanthos, ajo u përpoq të shmangte kandidaturën e Joakimit dhe ta zëvendësonte atë me Joanidhin, për të siguruar shumicën progreke në Sinod. Emzot Joakimi u vu në dijeni nga mbështetësit e tij në Sinodin e Shenjtë për këto synime, të cilët gjithashtu i sugjeruan të ndërhynte pranë autoriteteve shqiptare për të mbrojtur kandidaturën e tij.<sup>116</sup> Emzot Joakimi informoi Xhafer Ypin për këtë lëvizje të Patrikanës dhe kërkoi mbështetjen e tij dhe të Kryetarit të Republikës.<sup>117</sup>

Në kuadër të organizimit të kishës autoqefale, në shtator 1927, autoritetet kishtarë dhe shtetërore i kushtuan rëndësi përgatitjeve për festimin e pesëvjetorit të shpalljes së autoqefalisë së kishës ortodokse, në Kongresin e Beratit. Vëmendje e veçantë iu kushtua organizimeve në Korçë, e cila ishte kryeqendra e kishës. Në kishën e Shëngjergjit, kryetari i Këshillit të Lartë, At Vasil Marko, në prani të trupit diplomatik, të autoriteteve zyrtare qendrore e lokale, mbajti një fjalim, ku nënvizoi rëndësinë e vendimeve të Kongresit të Beratit për organizimin dhe për veprimtarinë e Kishës Ortodokse Shqiptare dhe për shtetin shqiptar. Më pas, ai, i veshur me uniformën ceremoniale fetare, i shoqëruar nga banda e qytetit, i ndjekur nga masa e madhe e besimtarëve ortodoksë dhe e besimeve të tjera, kryesisht ata myslimanë, të shoqëruar me të shtënat e topave, u drejtua për në mitropolinë e qytetit, ku u bë inagurimi i saj.<sup>118</sup> Gjithashtu, vëmendje iu kushtua edhe zgjedhjeve të tetorit 1927 për këshillat (dhimogjerondia) e mitropolive. Për të siguruar fitoren e elementit kombëtar, ata propozuan që zgjedhjet të kryheshin në mënyrë të

<sup>114</sup> *Gazeta Telegraf*, nr.46, 20 korrik 1927, f. 2.

<sup>115</sup> *Po aty*, nr. 45, 17 korrik 1927, f.1.

<sup>116</sup> *AMPJ*, V.1927, D. 238, fl. 80-84, Letër private (secret) nga Emzot Joakim, mitropolit i Pelagonisë, për Ministrin e Arsimit Xh. Ypi. Kailaria (Maqedoni), 29 dhjetor 1927.

<sup>117</sup> *Po aty*.

<sup>118</sup> “Ceremonia në kishën e Shëngjergjit”, *Gazeta Zëri i Korçës*, nr. 224, 13 shtator 1927, fl. 4.

drejtpërdrejtë nga populli ortodoks.<sup>119</sup> Në zgjedhje fitoi elementi patriot ortodoks. Këshilli i mitropolisë së Korçës i dalë nga ato zgjedhje, vendosi që kleri, në të gjitha kishat e vendit, të meshonte vetëm në gjuhën shqipe. Ai i kërkoi Këshillit të Lartë të evitonte çdo anomali që ishte konstatuar në mitropolinë e Gjirokastrës për përdorimin e gjuhës sonë amtare.<sup>120</sup>

Nënshkrimi i Paktit të Dytë të Tiranës, në nëntor 1927, konsolidoi më tej pushtetin e Zogut e të qeverisë së tij. Në dhjetor 1927, ata vendosën që, krahas hapave për organizimin e brendshëm të kishës, të fillonin përsëri bisedimet me Patrikanën. Në përgjigje të kërkesës së Patrikanës në maj 1927, Këshilli i Ministrave vendosi të dërgonte në Stamboll Komisionin e Posaçëm i cili do të realizonte marrëveshjen me Patrikanën, për zyrtarizimin e autoqefalisë së kishës dhe të merrte Tomosin.<sup>121</sup> Po në këtë mbledhje, u vendos t'i jepej përgjigje e letrës së 19 majit të Patrikut Ekumenik. Në përgjigjen shqiptare kërkohet, që bashkë me Sinodin e Shenjtë, të fillonin procedurën për plotësimin e vendeve bosh të selive të kishës, për të krijuar Sinodin shqiptar dhe, në zbatim të rregullores, të zgjidhej kryetari i kishës. Kështu, sipas përgjigjes shqiptare, do t'i jepej fund në mënyrë të pëlqyeshme çështjes së kishës, duke rregulluar dhe raportet e saj me Patrikanën, siç ishte vepruar dhe me kishat e tjera.<sup>122</sup> Në janar 1928, Sekretari i Sinodit të Shenjtë, arqimandriti Mxihos, vuri në dijeni konsullin N. Leskoviku se letra e qeverisë shqiptare për çështjen e kishës i ishte referuar Komisionit Sinodial.<sup>123</sup> N. Leskoviku më 12 janar zhvilloi një takim me Patrikun, prej të cilit mori premtimin se çështja e kishës do të zgjidhej para pashkëve.<sup>124</sup> Por, deri në fillim të prillit 1928, ai nuk mori asnjë njoftim. Më tej ai u informua nga burime konfidenciale se, pavarësisht dëshirës së Patrikut, Sinodi i Shenjtë, nën presionin e Athinës, nuk dëshironte zgjidhjen e çështjes së kishës sipas Akordit të Tiranës dhe "këmbëngulte

<sup>119</sup> *Gazeta Telegraf*, nr.417, 1 tetor 1927, fl.1.

<sup>120</sup> *Po aty*.

<sup>121</sup> *AMPJ*, V. 1927, D.235, fl.55, Vendim i Këshillit të Ministrave, nr.549 *Mbi Kishën Autoqefale Shqiptare*, Tiranë, 11 dhjetor 1927.

<sup>122</sup> *Po aty*, fl.56, Letër e Këshillit të Ministrave për Patrikanën. Tiranë 23 nëntor 1927; *po aty*, fl. 57, Letër e Ministrit të Jashtëm H. Vrioni drejtuar konsullit në Stamboll, Tiranë, 17 dhjetor 1927.

<sup>123</sup> *L'Eglise Autocephale ...*, fl. 43, Telegram i N.Leskovikut drejtuar Ministrisë së Jashtme, Stamboll, 12 janar 1928.

<sup>124</sup> *Po aty*.

për karakterin e gabuar të përzierjes së politikës në këtë çështje”.<sup>125</sup> Me të drejtë, shtypi i kohës, e konsideroi çështjen e kishës shqiptare, më të vështirë se sa çështja e Orientit.<sup>126</sup> Ndërsa gazeta “Dielli”, veç faktorit të jashtëm, bënte përgjegjës për situatën në KOSH, edhe klerikët më të lartë të saj, veçanërisht mitropolitin Jerotheos, i cili synonte të zinte postin e Kryetarit të kishës me ndihmën e Krisanthosit si dhe At Vasil Markon që, me mefshtësinë dhe pavendosmërinë e tij, kishte ndikuar negativisht, për t’u dhënë fund punëve të kishës.<sup>127</sup>

Në këtë situatë, Presidenti i Republikës, thirri në një takim të posaçëm, mitropolitin Jerotheos, Kristofor Kissin, kandidatin për Peshkop Kotokon, At Vasil Markon dhe anëtarë të Komisionit të Posaçëm P. Evangjelin, Koço Kotën etj. Ai u shfaqi dëshirën që çështja e kishës të zgjidhej sa më shpejt, duke nënkuptuar përfundimin e saj në mënyrë unilaterale.<sup>128</sup> Veprimi i qeverisë u kundërshtua nga Emzot Krisanthos. Nga Athina, ai shprehu keqardhjen për kthesën e qeverisë shqiptare, për të proçeduar në mënyrë të njëanshme në çështjen e kishës, pikërisht në kohën kur Patrikana e Shenjtë do t’i kërkonte asaj, qartësimin e disa çështjeve të letrës së 17 dhjetorit 1927.<sup>129</sup>

Pas takimit me Zogun, nisi puna për formimin e Sinodit dhe u caktuan si kandidatë mitropolit Kotoko dhe Joanidhi, të cilët erdhën në Shqipëri, për t’u dorëzuar si mitropolitë.<sup>130</sup> Në mbledhjen e organizuar nga Këshilli i Naltë, dorëzimi i tyre nuk u realizua, për shkak të pengesave nga mitropolitë të tjerë, sepse kandidaturat vinin në rrezik pretendimet e tyre personale për postet drejtuese të kishës, si për shkak të interesave të qarqeve të huaja që përfaqësonin.<sup>131</sup> Pengesë kryesore për ngërçin e krijuar në Këshillin e Naltë, sipas N. Leskovikut ishte kryepeshkopi i Korçës Jerotheos i cili, në bashkëpunim me Emzot Krisanthosin, i kishin dërguar Patrikanës një letër ku zotoheshin se ata

<sup>125</sup> *Po aty*, fl.44, Telegram i N. Leskovikut, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Stamboll, 4 prill 1928.

<sup>126</sup> *Gazeta Telegraf*, nr. 79, 13 nëntor 1927, f.2.

<sup>127</sup> *Gazeta Dielli*, nr. 4081 (774), qershor 1928.

<sup>128</sup> *Gazeta Dielli* nr. 4080 (773), 12 qershor 1928, f.4.

<sup>129</sup> *L’Eglise Autocephale* ..., f. 45, Telegram i Emzot Krisanthos, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Athinë, 8 maj 1928.

<sup>130</sup> “Mbi vonesat për krijimin e sinodit” në *Gazeta e Re*, nr. 46, 25 dhjetor 1928, f. 4, Intervistë me Hirësinë e tij Kristofor Kiss, mitropolit i Beratit; *Dielli*, nr. 4078 (771), 5 qershor 1928, f.4.

<sup>131</sup> *Gazeta e Re*, nr.11, 13 nëntor 1928, f.1.

dhe kolegët e tyre në Shqipëri, nuk do të lejonin që punët e kishës të rregulloheshin sipas dëshirës të qeverisë shqiptare.<sup>132</sup> Informacioni i N. Leskovikut ishte një argument i fortë që dëshmonte për mungesën e sinqeritetit të Patrikanës për zgjidhjen e çështjes së kishës dhe i jepte të drejtë qeverisë shqiptare për të inkurajuar më tej kryepeshkopët që ta zgjidhnin vetë këtë çështje. Presioni në shtyp u shtua. Autorë të ndryshëm në shkrimet e tyre kërkonin t'i jepej fund çështjes së kishës. Ata i kujtonin peshkopit Jerotheos, se “Korça është Shqipëri dhe jo Greqi. Dhe po të mos heqë dorë nga këto do ta pësojë si Jakovi”.<sup>133</sup>

Megjithë përpjekjet e qeverisë shqiptare, të klerit ortodoks dhe forcave atdhetare për zgjidhjen e çështjes së kishës, gjatë viteve të Republikës nuk u arrit zyrtarizimi i pavarësisë së saj. Rëndësia që paraqiste ajo si në planin kombëtar ashtu edhe për normalizimin e marrëdhënieve me fqinjin jugor, bëri që përpjekjet për zgjidhjen përfundimtare të saj të vijonin edhe në periudhën e Monarkisë.

### *S u m m a r y*

#### THE ISSUE OF AUTOCEPHALY OF ALBANIAN ORTHODOX CHURCH (1925-1928)

The study is devoted to the process of instituting to the Autocephaly of Orthodox Albanian Church (OACH) by the Orthodox Patriarchate in Istanbul during the years 1925-1928, which was declared by the Congress of the Orthodox community in Berat in 1922. The progressive forces within the country and in the diaspora, considered it as an important factor for the consolidation of the Albanian state and strengthening of its independence.

Based on archival documents and historiographical literature, the article analyzes the attitude of Ahmet Zogu to the issue, his commitment, the Albanian government and patriotic figured inside and outside the church, to advance the process and the efforts of the Greek official and Church circles, which aimed to maintain their influence in Northern Epirus and the protectorate over the Albanian Orthodox Church in cooperation with the Orthodox Patriarchate of Istanbul. It also reflected the Albanian Government's efforts to resolve the issue

<sup>132</sup> *L'Eglise Autocephale* ...., f.49, Telegram i N. Leskovikut, drejtuar Ministrisë së Jashtme, Kostandinopojë, 16 gusht 1928.

<sup>133</sup> “Probleme të fesë”, *Dielli*, nr.4080 (773), 12 qershor 1928.

---

in cooperation to the Patriarchate, but its continued reluctance to issue the certificate of autocephaly, forced the Albanian government to undertake unilateral steps in the building of leading bodies of OACHA.

